REVISTA E KOMUNITETIT SHQIPTAR NE BRITANINE E MADHE - MAGAZINE FOR THE ALBANIAN COMMUNITY IN THE UK AND REPUBLIC OF IRELAND

ALBANIAN POST

Nr. 02

TETOR / OCTOBER 2018

Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - **Telephone:** 07984497444 - albanianpost@mail.com - www.albanianpost.co.uk - www.fjalaelire.com

20 Amnistia…

04 Divorci…

14 Respekti…

SHQIPËRIA IME

Enjomur. E tëra në mal, fushë, lumë, liqen dhe det. Jon dhe Adriatik: trupi më me fat në planet. Vala pas valës ngrihet e ulet madhërishëm mbi të dhe e bën pakt. Nuk është meditim. As vetëdije nuk mbetet të jetë. Është natyra. Ajo del nga monotonia, ndërgjegjja e përhershme e përditshme. Ngrohja është kod më vete. Nga letrat e fjalët e largëta zbret e ul këmbëkryq shekujt në Odën e Mikut. Rrezet e Diellit nuk kanë dashur, nuk duan ende kremëra mbrojtës mbi trupin e saj. Ajo është e tillë nga Lindja. Ajo ka mbetur e tillë në jetë të jetëve. Nuri zbret mbi trupin e saj të zhveshur, duke e përkëdhelur me butësi të madhe dhe, pak nga pak, Ajo zbulohet si një Perlë më vete. Ndonjëherë, kur kjo zvenitej, ishte e vështirë për të që të kthehej në botën që ajo kishte luftuar kaq shumë për të fituar një pamje të kontrollit në Konkursin e Madh të Bukurive. Ishte e vështirë! Poetët dhe letrat u shkruan s'kishin (a) radhë. Ndodhte kështu, sepse...

(vjon ne faqen 02)

RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

24/7 orë linjë emergjence
07878335000

Specializuar në emigracionin e Britanisë së Madhe

RASHID & RASHID LAW FIRM
Main Office:
190 Merton high street,
Wimbledon, London, SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666
Gena: 07774222062

211, The Broadway, Southall,
UB1 1NB
law768@live.com
Tel: 02086720666
Fax: 02085430534

Një minutë larg nga South Wimbledon Underground Station

(vjon nga faqja 01)

... duke fituar këtë kontroll, gjithçka që duhej dhe e donte, me të vërtetë, ishte të largohej prej saj. Dhe ashtu mbeti?! Përsëri në një fushë ku kontrolli nuk ishte një çështje, jo diçka që duhej ta posedonte për vete. Kishte diçka në rrjedhën e valëve të Jonit dhe Adriatikut, diçka në mungesë sigurie për t'u prekur dhe tunduar nga sasia e madhe dhe e panjohur e detrave më mitikë në Tokë, që ishte problematike. Deformuese. Sfumuese. Dhimbëse. Tronditëse. Por Ajo mbeti Zonjë e radhë! Kënaqësinë e ka në gjirin e saj të madh. Ajo nuk e dinte se si ta linte kënaqësinë që e solli, aq brutalisht në një sfond "primal". Kjo ndodhi kur duart e të dashurve të saj vunë lakmi në Trupin dhe Nurin e saj. U bë kaos. Pra, pafundësisht jashtë kontrollit, në një vend ku ajo nuk kishte asnjë arsye ta pranonte dhe ta meritonte atë. Pa aftësi?! Dhe nuk ishte më një masë e mendimeve dhe tmerreve të marramendura, aq sa ajo thjesht ishte ... ishte dhe është Shqipëria Ime! ... një Parim jetik, i rrënjosur, i bukur dhe i plotë në transhin e ekzistencës së saj. Në jetëjetën time!

SA "BALTË" NË ART?!

Martin Heidegerr tek **"Poezia, gjuha, mendimi"** shprehet: "Artisti është origjinë e punës. Puna është origjinë e artistit." Po asgjëja? Më saktë, jo puna? Jo arti? Jo artisti? Çfarë lidhje kanë? Të gjitha këto që anojnë nga enigma e kësaj lidhjeje reciproke, nga jo arti, nga jo artisti janë në një lidhje të padukshme. Janë lidhje tek asgjëja. Asgjëja është pa të tjerat. Asgjëja është më saktë asnjëra, sipas Heidegerr. Asnjëra është mbështetja e pandjeshme e e të tjerave. Pra e enigmave të tjera, që janë larg nga këto lidhje, por që ne i quajmë gjëra. Gjëra të rastit, gjëra të ditës, gjëra të ndodhura, gjëra që ndodhin, gjëra që debatohen. Gjëra që vijnë nga hedhja e një guri në ujin e madh të turbullirave dhe të mijëra të tjerëve që sillen e sillen vërdallë, pa e kuptuar se gjëja ishte ai gur në atë ujë, por që ndodh që asnjëherë s'e nxjerrin dot. E, kështu asgja dhe asnjëra kanë një lidhje sa të dukshme, aq dhe të padukshme me njëra-tjetrën.

Sikurse ndodh që gjërat janë produkt i një gjëje, dhe sikurse dihet që artisti është origjinë e punës në rrugë të ndryshme arti është origjinë e të dyve, e artistit dhe punës. Asgjëja dhe asnjëra janë këputja e plotë e hallkës që lind dhe vdes tek gjërat. Gjërat që i sjellin natyrshëm "gurët" e hedhura në ujin e madh e të turbullt. Edhe pse vetë fjala "art" është një kompleks i krijuar për të simbolizuar një nocion kolektiv. Dhe të gjitha shkojnë më tej deri tek një rreth i pakompletuar mirë ende. Puna e artit është njësoj si një minierë ku ka mineral, gurë, llucë dhe baltë. Ku ka dhe asgjë. Ku funksionon dhe asnjëra nga të gjitha. E diku quhet art. Më së shumti art pa standart. E diku e ka një fjalë, një gjësendi në atë fjalë, një… baltë, që edhe pse e ndyn përditë e ngadalë nuk mund të quhet art. E ndoshta pse është punë, dhe pse puna ka lidhje me artistin dhe artisti me punën, kjo "baltë", ndryshe nga ajo e skulptorit, bën sot baltë tërë atë që quhet dhe s'quhet art. Kjo "baltë" mbledh njerëz në salla të mëdha, me fis e me lis, me laps e me laptop, me … të gjitha lidhjet tek asgjëja, dhe po aq te asnjëra, për ti bërë bashkë "eseninat" e kohës moderne në baltosjen e madhe të ardhur nga koha me promovime librash, arti, dhe …asgjëje.

Ju duhet një avokat?
Ne do të flasim për ju.

Duncan Lewis
Solicitors

Emigracion

Gjoleja në familje

Divorci
dhe dhuna në
familje

Pasiguri dhe pasoja ligjore

Krizat dhe mashtrimet

Lirimet personale
dhe ngjitshmëria
ngjitshmore

Ngjitshmëri profesionale

Shkëndet mendore

QEVERIA TË FILLOJË KONSULTIMET PËR DIVORCIN PA FAJ

Nga Adeeba Naseem

Sekretari i Drejtësisë David Gauke pritet të nisë një konsultim mbi futjen e propozuar të divorceve 'pa faj', duke i lejuar partnerët të divorcohen pa u fajësuar asnjë palë për prishjen e martesës. Një propozim i tillë do të modernizonte legjislacionin që nuk është ndryshuar për më shumë se 40 vjet.

Kjo vjen pas disa rasteve të raportuara të shkurorëzimit, më së shumti Owens v Owens, në të cilën Gjykata e Lartë vendosi që Tini Owens nuk mund ta divorconte burrin e saj prej 40 vjetësh, duke konsideruar një martesë jo të mirë për shkak të divorcit të papërshtatshëm. Sipas Aktit të Shkaqeve Matrimoniale 1973, bazat aktuale për divorc përfshijnë;

- **Tradhtia**
- **Braktisja**
- **Sjellja e paarsyeshme**

Shkurorëzimi mund të jepet edhe nëse palët kanë jetuar për një periudhë të pandërprerë prej dy vjetësh dhe të dy kanë pranuar të divorcohen, përndryshe ata duhet të jetojnë veç për pesë vite para se të mund të lëshohet divorci. Thirrja e Gaukes për konsultim është përmbushur në një masë të madhe me miratim. Sekretari i Drejtësisë i Qeverisë Hije, Richard Burgon pohoi se Laburistët mbështesin futjen e divorceve pa faj. Megjithatë, ai sugjeroi që;

"Në vend të një konsultimi tjetër, konservatorët duhet të vazhdojnë me ndryshimin e ligjeve tona të divorcit në mënyrë që ata të përshtaten për shekullin e 21-të." Ish-kryetari i organizatës për të Drejtën familjare, Nigel Shepherd, beson se konsultimi ka potencial të jetë një moment historik për ligjin e divorcit në Angli dhe Uells.

"Për shumë kohë, çiftet janë detyruar të kalojnë në ashpërsi dhe konflikte të panevojshme për të përmbushur një kërkesë ligjore të vjetëruar." Ai shpjegoi.

Gjithashtu duke mbështetur propozimin, presidentja e Shoqërisë Ligjore, Christina Blacklaws tha;

"Bërjen e atributit të çifteve gabim, në mënyrë që të përfundojë martesa e tyre, mund të përshkallëzojë dallimet midis tyre në një situatë tashmë të ngarkuar. Ne i mirëpresim lajmet që Ministria e Drejtësisë duhet të konsultohet mbi propozimet për azhurnimin e ligjit të divorcit". Drejtoresha e Familjes dhe e Kujdesit ndaj Fëmijëve në Kompaninë Avokatore Duncan Lewis, **Adeeba Naseem** është optimiste rreth ndryshimeve të propozuara;

"Zgjedhja e fajit nga procesi i divorcit do të mirëpritej nga shumë bashkëshortë, që përballen me mundësinë e trajtimit të procedurave të divorcit dhe pa dyshim do të reduktonte numrin e rezultateve, financimit stresues dhe procedurave të fëmijëve".

Adeeba Naseem, Drejtoreshë e Familjes dhe e Kujdesit ndaj Fëmijë në Duncan Lewis, rregullisht merret me ndarjen, shkurorëzimin dhe procedurat financiare (vendore dhe ndërkombëtare), duke përfshirë marrëveshjet para lindjes dhe pas lindjes, dhe rastet e rralla që përfshijnë Queens Proctor. Ajo është e specializuar në trajtimin e procedimeve ndërkombëtare dhe familjare në Gjykatën e Lartë.

Kontaktoni Adeeba në **020 3119 0220** ose përmes emailit në **adeeban@duncanlewis.com.**

Avokatët e Familjes të Duncan Lewis Ekipet tona familjare dhe të kujdesit për fëmijët janë të specializuar në të gjitha aspektet e çështjeve të së drejtës familjare dhe private / publike të fëmijëve nga zyrat në të gjithë Anglinë dhe Uellsin. I njohur nga Legal 500 2017, ekipi ka përvojë në çështjet komplekse financiare martesore (lehtësim ndihmës) në lidhje me ndarjen e një martese / marrëdhënie, me një praktikë të gjerë që përfaqëson prindërit, anëtarët e familjes dhe fëmijët nëpërmjet kujdestarit të tyre në të gjithë fëmijët.

Për këshilla të ekspertëve, kontaktoni ekipin tonë të familjes specialist dhe avokatët e divorcit në

0333 772 0409.

RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

24/7 orë linjë emergjence

07878335000



Specializuar në emigracionin e Britanisë së Madhe

Avokatët tanë të emigracionit kanë mbi dhjetë vjet përvojë në fushën e emigracionit dhe ligjit të azilit.

Çdo klient është po aq unik sa është rasti që ata na sjellin

Rashid & Rashid Solicitors, si të gjithë avokatët e tjerë në praktikë në Angli dhe Uells, është Kompani e autorizuar dhe e rregulluar nga Autoriteti i Rregullimit të Aplikantëve.

Një minutë larg nga South Wimbledon Underground Station

Për të biseduar në shqip telefono Gena:

07774222062

- Dokumente udhëtimi
- Procedura për leje qëndrimi dhe viza
- Kur jeni kotigjent per t'u riatdhesuar ose të ndaluar nga organet e emigracionit
- Mbulojmë të gjitha aspektet e emigracionit
- zgjatje vizash
- Leje pune
- Rishikim jurdik
- Apelim Tribunali
- Rastet e trashëgimisë

RASHID & RASHID LAW FIRM
Main Office:
190 Merton high street,
Wimbledon, London, SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666
Gena: 07774222062

211, The Broadway, Southall,
UB1 1NB
law768@live.com
Tel: 02086720666
Fax: 02085430534

METAFORAT E POLITIKËS DHE LETRAT SHQIP

__Lulzim Basha__ kohë më parë është shprehur për Edi Ramën: "Erdhe si Rilindas dhe po ikën si Taleban…" (2.11.2017). Ndërsa __Edi Rama__ ka thënë: "Është djalë i mirë Luli …është artist". (28.12.2017).

Jo pak herë "Fjalori" i Politikës shkon përtej metaforave. Po aq herë i kalon dhe caqet e pragjet e krahasimit. Kështu metaforat dhe krahasimet, këto gjëra elementare që mësohen në shkollë, madje që herët në bangat e saj, janë në majë të dhëmbëve kafshues të politikës në një luftë civile të paparë ndonjëherë në të majtë e në të djathtë të politikës. Sakaq përtej kësaj rutine ku ndodh kërcitja e fjalëve nën dhëmbë, metaforat dhe krahasimet hyjnë ngadalë e pa u ndier në media, përditësi e më thellë akoma në krijimtari. Përse ndodh kjo në politikën shqiptare? Përse ndodh që pastaj dhe krjimtaria të ushqehet nga metafora dhe krahasime të tilla? Kjo ndodh sepse duket qartë se nuk ka shumë arsye të tjera tipologjike. Nuk është ndonjë gjë që ka ndodhur vetëm vitet e fundit. Nuk është risi e re. Kjo ka vazhduar që në gen të Shtetit Shqiptar. Që në zanafillë të fjalës politike shqiptare. Dhe ka bashkëudhëtuar gjatë 100 e kusur viteve në politikën shqiptare, madje mjaft fuqishëm dhe në monizëm. Kjo e ka burimin tek retorika. Retorika është në qendër të politikës. Dhe metafora është në qendër të retorikës. Historia kthehet dhe forcon retorikën me metafora, që pastaj të bëjnë forra dhe në krijimtari. Ky nuk është thjesht burimi, as mësimi, por forca ku krijimtaria merr nga metafora dhe krahasimi. Kjo është përditësia më e "ushqyeshme" nga politika, ku kryqëzohen teoria dhe praktika. Ku natyrisht bashkëveniten edhe letërsia, edhe politika.

Mbaj mend më herët, kur punoja në Shqipëri në një nga gazetat më të shitura të viteve të para të Demokracisë Shqiptare, ku njerëzit rrinin në radhë për ta blerë atë. Mbaj mend pikërisht ditën kur diskutohej se Kryeministri i asaj kohe kishte thënë se "Shqipëria ka bukë vetëm për tre ditë". Gazeta në të cilën unë punoja ishte në të djathtë dhe fuqimisht e shfrytëzonte "gafën" e politikës. Por nuk duhej thënë se "Bufi kishte të drejtë", nuk duhej thënë aq thjeshtë. Duhej shkruar me të madhe: "Kriminelët e zhvatën Shqipërinë. E lanë popullin pa bukë!" Kaq duheshe atëherë. Kaq dhe grushtat e shkelmat shkuan në përditësi. Në radhët e bukës zbritën dhuna dhe maskuliniteti i djemve të agresuar. Zbriti fjala e mbushur me metaforat e politikës dhe krahasimit dhe librat filluan të fryheshin me to. Politika dhe letërsia ishin ushqim i përbashkët mes metaforave dhe krahasimeve të tilla. Dhe u pa se metafora dhe krahasimi në politikë ishte domosdoshmëri. Në letërsi pos këtij ushqimi, ndodhte të kaparceheshin caqet, deri përtej kufirit të lirisë së fjalës. Dhe a kishte, ka dhe a duhet të ketë kufi Fjala e Lirë?

Përditë dëgjohen metafora dhe krahasime për "veting"; "teatër"; "fshehje të të ardhurave" dhe aspak për "letrat" shqipe. Aspak!!! Ata flejnë nën ritmin e flokëve të Ministres Kumbaro, që metaforat e politikës e tundin dhe shkundin fort vetëm për arsye "politike". Të tjerat janë më lart. Lulzim Basha kohë më parë është shprehur për Edi Ramën: "Erdhe si Rilindas dhe po ikën si Taleban…" (2.11.2017). Ndërsa Edi Rama ka thënë: "Është djalë i mirë Luli …është artist". (28.12.2017). Këto ishin në mbydhje të një viti më parë. Por si këto ka dhe qindra më pas dhe do të ketë me dhjetëra deri në mbydhje të këtij viti. Ka se metafora dhe krahasimi në politikë përdoren për të sulmuar dhe çnjerëzuar politikën dhe politikanët. Po ushqimi i saj në Letrat Shqipe përse ndodh vallë?!

ILIA RECOVERY SERVICE

Shërbimet profesionale. Jemi pranë jush kudo në UK dhe Europë

- Cars - Mini Vans - Bikes - Caravan
- Motorway - Accident - Recovery
- Towing Service - No feul Service - Home Start
- eBay - COPART -H.B.C all Action & Salvages Collections

EMERGENCY 24 ORË SERVICES

TELEFONI: 07735554555 ose 07466108992

THE BALKAN
BAR & RESTAURANT

66c Ealing Road,
Wembley,
HA0 4TH

Salla moderne për dasma dhe okazione të tjera festive, familjare dhe shoqërore.

Kapaciteti i sallës kryesore:
150 vetë.

Kapaciteti i sallës pritëse:
80 vetë.

Shërbim profesional. I kulturuar. Modern. Çmime konkuruese.

5 minuta nga Undergroundi Wembley Central

07429459851

24 NENTOR 2018 - LONDER
GEZUAR 106 VITE SHTET
AFRIM ALIU
NIRVANA - ELTON QERA
Royal Restaurant

HESHTJA USHQEN ARROGANCËN

Kompleksiteti i situatave të krijuara në politikën shqiptare, dhe ndarja në veprime, jo aq qartë në mendime, po aq sa edhe paaftësia në Qeveri e qeverisjen e sotme, ka krijuar një "mençuri kolektive politike" që të lë të kuptosh se asnjë marrëveshje s'mund të mbetet reale, asnjë marrëveshje nuk është trauma ekzistenciale përballë fakteve reale dhe tronditëse të shqiptarit të thjeshtë, njeriut që ende aritmetikën e tij të kuletës e ka tek buka dhe uji i përditshëm. Kjo strategji e fshehur dhe e strukur, e heshtur në zhurmën e përditësive dhe e heshtur në skutën aktuale qeverisëse nuk është vetëm një strategji e mençur por edhe e rrezikshme edhe për vetë opozitën, së cilës zëri i saj i drejtë nuk i përçohet askund, e jo më në këtë mjedis ku mendohet vetëm për të kaluar ditën.

Ndërsa fokusi gjithnjë e më i madh mbetet në mesin e mosmarrëveshjes, ku bie në sy fenomeni tipologjik i zhurmës pos heshtjes, fill pasi dhe opozita e transferoi mbledhjen e saj në Shkodër, duke imituar dhe rimorkiuar mbledhjet tipologjike "alla-Rama" të Qeverisë nëpër qytete të ndryshme, tashmë ka hedhur dritë mbi kontradiktat e projektit heshtanak qeveri-opozitë, paralajmërimet për kaos dhe mosmarrje pjesë në Parlamentin e sotëm nga Opozita; të bërit publik të thirrjeve për protesta masive deri në rrëzimin e kësaj qeverie, si një model i së shkuarës; mosvëmendja tek të rrinjtë që dita-ditës sytë i kanë të ikin, ndërsa shtete të tjera, përfshirë së fundi dhe BM që lëshon thirrjen për të mbajtur studentët të punojnë dhe jetojnë deri dy vite pas graduimit pa ndonjë problem ligjor. Aq shumë për "heshtjen" e një zhurme që transferohet pa ide dhe vetëm me mide personale, të politikës aktuale shqiptare. Aq shumë për zhurmën e heshtur të vetë heshtjes së zhurmshme.

Në këtë heshtje tre të katërtat e publikut shqiptar tani besojnë se qeveria po i trajton keq e më keq shqiptarët, fatet e tyre, fatet e të rrinjve, fatet e të gjithëve. Litia e barsoletave të Ramës, sa në rolin e Kryeministrit të vendit me një pamje tipologjike në sytë e Botës, aq dhe në spotet thumbues, ka bërë heshtjen të bëjë zhurmën e vetë heshtjes, si një stilin që

keq e më keq udheditëson fatin për për kryeministrin që flirton heshtazi me aleatët evropianë, në një kohë që kompleksiteti i së shkuarës i ka lënë jo pak probleme në lëvizjet e Bashës dhe aleatëve të tij opozitarë. Për këtë Basha dhe aletatët e tij dhanë shenjën e parë të bllokimit të Parlamentit. Padyshim, nënkuptimi shkon më tej, që do të ketë më shumë bllokime, takime më të shpeshta dhe vazhdime të mëtejshme për të shkëputur vëmendjen e heshtjes masive shqiptare, por shancet flasin për asnjë marrëveshje. Kjo ka një rrezik shumë më të madh sesa asnjë marrëveshje, pasi Rama i favorizuar nga heshtja masive shqiptare, si një ish sportist i vjetër i topit, e di skutën e një loje dhe një lojë e tillë e vogël apo edhe më e madhe është vetëm një lojë. E gjithë situata është dhe mbetet në lojë.

Kryeopozitari Basha, po aq Kryemadhi, Vasili e të tjerë, e kanë kuptuar këtë dhe pjesa tjetër e ka në vëmëndje prej kohësh, ajo pjesa më e heshtur e ndjek me një sy e me një veshë: një situatë akoma më e keqe për shqiptarët nga kjo qeverisje e favorizuar nga shumë gjëra të bëra publike, por dhe nga kjo heshtje e madhe masive, po aq dhe intelektuale, për të cilën askush nuk ka votuar dhe kurrë s'e ka dëshiruar. Kjo mbetet lojë, një lojë akoma më e madhe në favoret e ardhura nga kjo heshtje, që apriori u lexua si e tillë në Twitter në një postim të shpejtë të Ramës: "Kur duhet të jetë në Tiranë, shkon në Shkodër. Kur duhet të hyjë në zgjedhje, futet në çadër. Kur duhet të shkojë në punë, rrotullohet në gjumë. Kur humbet, shpall fitoren. S'kemi ç'i bëjmë, duhet të bëjmë dhe pa të. E gjithë vëmendja te njerëzit!".

Pra loja është e qartë. E gjithë vëmendja tek heshtja, heshtanakët, tek ata që mbajnë gjallë dhe në këmbë ende Ramën dhe grupin e tij të qeverisjes. Nëse nuk është kjo heshtje, nëse "vëmendja te njerëzit" nënkupton ndërgjegjësim do të ishte e qartë se që të jesh një centimetër jashtë situatës mjerane të kësaj qeverisjeje është një milion kilometra nga të qenit brenda mijëra problemeve që kanë shqiptarët sot. Basha dhe mjaft të tjerë kanë paralajmëruar me kohë për këtë. Ata janë plotësisht të fokusuar në nxjerjen e heshtjes nga gjumi. Dhe vetëm pastaj do të ketë arsyetime dhe shpresa ndaj të drejtave sociale, ekonomike dhe njerëzore të garantuara me shpresën në anëtarësimin në BE.

Rreziku i vërtetë tani është se katastrofa e vazhdimit të përkeqësimit shkon përtej heshtjes dhe heshtanakëve, pasi kjo nuk arrihet dhe nuk bëhet pikë referimi ndaj dhe lëvizjet politike janë si tërmetet e shumta, të vogla e të shpeshta që ndodhën verës që lamë pas. Unë mendoj se heshtja përfundimisht do të zgjonte nga gjumi heshtanakët, vetëm duke bërë të qartë udhën e së nesërmes, me një paketë realiste (dhe jo të komplikuar) me vetë prezencën dhe fatin intelektual në Shqipëri, duke projektuar për zgjidhje çështje të vështira që janë bërë gangrenë që në periudhën e tranzicionit. Kjo pastaj do të vrasë frikën publike dhe politike dhe nuk lë shkas për asnjë marrëveshje në presion moral dhe politik për të bërë që intelektualët të ndjekin qoftë dhe deputetët në vijë të stërhodhuar. Asnjë marrëveshje me intelektualët, do të thotë shtim i heshtjes, kështu e gjitha, lëvizja dhe iniciativa nuk do të shkojë dhe anojë aty ku duhet, tek kërcënimi ndaj Qeverisë, por thjesht ndaj një shkopi të përdorur nga Qeveria për të fituar mbështetje për planin e saj të dështuar. A do të ketë sukses me zgjimin intelektual?

“THE IMPERIAL VENUE” VENDI I TRADITAVE SHQIPTARE

“Në “The Imperial Venue”, në këtë mjedis kaq modern dhe komod ndodh që të ndjehesh tejet miqësor dhe kështu vetëkupton se ambienti te ka berë për vete, të jep forcë dhe krahë që gwzimi, dasma, fejesa, apo dhe evenimenti tjetër familjar të shkojnë sikurse ta do zemra. E kjo ndodh natyrisht në “The Imperial Venue” në adresën 290 West Green Road, London N15 30R, jo thjesht për një natë të gëzuar, por për të bashkuar traditën e memorjen e traditave.”



The Imperial Venue

Sallë dasmash dhe eventimentesh të mëdha e të ndryshme

qeraj@hotmail.co.uk

07446070501 & 07960766551

290 West Green, West Green, London, N15 3QR

VILA RONEL
VILA RONEL
Vila Ronel Bar & Restaurant
46 Birchington Road
London, NW6 4LJ
020 7624 1385
www.vilaronelrestaurant.co.uk
Reservation@vilaronelrestaurant.co.uk

Speciale:
CILI ËSHTË POZICIONI LIGJOR I EMIGRANTËVE 10 VJETË TË PALIGJSHËM?

Intervistë me Drejtuesin e Kompanisë Avokatore, Av Rashid Khan.

Albanian Post: A ka ndonjë rrugë zyrtare në dispozicion sipas ligjit të imigracionit në Mbretërinë e Bashkuar për të rregulluar statusin tuaj të imigracionit?

Av. Rashid Khan: Nëse jeni shtetas jo-BE që jetoni në MB pa leje të vlefshme për të hyrë ose mbetur, do të klasifikoheni si një emigrant ilegal. Ju mund të keni hyrë në Mbretërinë e Bashkuar në mënyrë të ligjshme, ose për një vizitë të shkurtër për punë, studim ose për të vizituar familjen, dhe më pas u larguat pasi leja juaj për të qenë në MB kishte skaduar. Apo ndoshta keni shkelur kushtet e vizës tuaj dhe si rezultat pushimi juaj është shkurtuar. Ose mund të keni hyrë në Britani të Madhe duke kërkuar azil, por nëse kërkesa ose ankesa juaj u refuzua. **Cilado qoftë arsyeja, nëse jeni aktualisht në MB në mënyrë të paligjshme, jeni në rrezik deportimi.**
Përderisa **amnistia e emigracionit të paligjshëm mbetet temë e debatit të përgjithshëm,** duket një perspektivë e largët nën qeverinë aktuale dhe mandatin e saj për të reduktuar ndjeshëm emigracionin neto.

Albanian Post: Atëherë ku qëndron ligji?

Av. Rashid Khan: **Siç qëndron ligji**, një emigrant 10 vjeçar i paligjshëm do të mbetet i paligjshëm nëse ata nuk mund të konstatojnë një mënyrë për të rregulluar ligjërisht statusin e tyre në Britani të Madhe. E drejta ligjore për të hyrë dhe për të qëndruar në MB mund të merret vetëm përmes një aplikimi zyrtar në Home Office dhe do të varet nga rrethanat tuaja individuale.

Albanian Post: Si mund të bëhet regullimi i statusit të imigracionit si një imigrant ilegal 10 vjeçar?

Av. Rashid Khan: Nëse keni jetuar në mënyrë të paligjshme në Mbretërinë e Bashkuar, mund të jeni në gjendje të rregulloni statusin tuaj duke aplikuar tek Sekretari i Shtetit për të dhënë një periudhë pushimi diskrecionale jashtë Rregullave të Emigracionit. **Një nga aplikimet më të zakonshme për leje diskrete** është ajo ku mund të tregoni lidhje të forta dhe familje në Mbretërinë e Bashkuar dhe ku deportimi do të ndikojë në të drejtat tuaja njerëzore. Në këto rrethana, ju mund të jeni në gjendje të aplikoni për të rregulluar statusin tuaj të emigracionit sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).
Neni 8 i KEDNJ-së përfshin të drejtën për respektimin e jetës familjare dhe private dhe mund të ofrojë një gamë të rrugëve të ndryshme për marrjen e lejes për të qëndruar. Ju mund të bëni një aplikim zyrtar të Nenit 8 në Zyrën e Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar. Çdo aplikim do të konsiderohet rast pas rasti, duke marrë parasysh rrethanat tuaja individuale.
Do të jetë e rëndësishme që çdo rast që paraqitni për leje diskrete është i saktë dhe gjithëpërfshirës, duke evidentuar, për shembull, një jetë familjare të vendosur, një qëndrim të gjatë në Mbretërinë e Bashkuar dhe një regjistër të pastër kriminal. **Nëse jepet leja e lejuar, fiton të drejtën për të jetuar dhe punuar në MB.**

Albanian Post: **Cila është baza për aplikimin e Nenit 8 si një imigrant ilegal 10 vjeçar?**

Av. Rashid Khan: Aplikimi për leje për të qëndruar në MB në bazë të jetës familjare ose private shpesh është referuar si **'partneri, prindi ose jeta private e njeriut'** (Shtojca FM Seksioni 1). Në këtë mënyrë ju mund të merrni të drejtën për të aplikuar për zgjidhje 10 vjet pas lëshimit të lejes së parë.
Rruga partnere është potencialisht e disponueshme për ata që janë në Britani të Madhe si partnere e dikujt që është britanik ose është vendosur në Mbretërinë e Bashkuar, ose është në Mbretërinë e Bashkuar me leje të kufizuar si refugjat ose ka dhënë mbrojtje humanitare. **Një partner përfshin bashkëshortin, partnerin civil, të fejuarin (e) ose partnerin e propozuar civil, ose që ka jetuar së**

bashku me aplikantin në një marrëdhënie të ngjashme me një martesë ose partneritet civil për të paktën 2 vjet përpara datës së aplikimit.
Rruga mëmë siguron një bazë në të cilën leja për të qëndruar mund t'i jepet një prindi i cili ka përgjegjësinë e vetme ose të drejtpërdrejtë aksesin tek një fëmijë që jeton në MB. Këtu fëmija duhet të jetë ose një qytetar britanik, ose ka jetuar në MB në mënyrë të vazhdueshme për 7 vjet menjëherë para datës së aplikimit dhe nuk do të ishte e arsyeshme të pritet që fëmija të largohet. Ku përfshihen fëmijët, do të shqyrtohen interesat më të mira të fëmijës, të cilat nuk duhet të ndikohen përgjithësisht nga sjellja ose historia e emigrimit të prindërve.

Albanian Post: Po rruga e jetesës private?

Av. Rashid Khan: Rruga e jetesës private gjithashtu mund të jetë e disponueshme për ju nëse keni jetuar në MB për një periudhë të konsiderueshme kohore, në veçanti:

1. ju keni jetuar vazhdimisht në MB për të paktën 20 vjet.

2. jeni nën moshën 18 vjeç dhe keni jetuar vazhdimisht në Britani të Madhe për të paktën 7 vjet dhe nuk do të ishte e arsyeshme të prisni që të largoheni nga Britania e Madhe.

3. ju jeni të moshës 18-25 vjeç dhe keni kaluar të paktën gjysmën e jetës suaj duke jetuar vazhdimisht në MB.

4. jeni 18 vjeç ose më lart, keni jetuar vazhdimisht në Britani të Madhe për më pak se 20 vjet, por do të keni pengesa shumë të rëndësishme për integrimin tuaj në vendin në të cilin do të duhet të shkoni nëse kërkohet të largoheni nga Britania e Madhe.

Kriteret e ndryshme për përshtatshmërinë dhe përshtatshmërinë zbatohen për çdo rrugë, me kërkesa të rrepta që peshojnë kundër një aplikimi të suksesshëm, ku një aplikant ka jetuar në MB në mënyrë të paligjshme për periudha të zgjatura kohore. Megjithatë, nëse ka dëshmi për rrethana të jashtëzakonshme që do të bënin refuzimin e një shkelje të nenit 8 sepse do të rezultonte në pasoja të pajustifikueshme të ashpra për aplikantin ose familjen e tyre, atëherë leja për të mbetur ende mund të jetë grant.

Albanian Post: A do të marrë parasysh Zyra Kombëtare (Home Office) rrethanat rreth hyrjes dhe qëndrimit në Britani të Madhe

Av. Rashid Khan: Zyra Kombëtare (Home Office) do të marrë parasysh rrethanat rreth hyrjes dhe qëndrimit në Britani të Madhe, si dhe përqindjen e kohës që ata kanë qenë në MB ligjërisht në krahasim me ilegalisht. Nëse aplikimi juaj është i suksesshëm, ju do të lejohet leja e kufizuar për 30 muaj. Ju mund të aplikoni për të zgjatur këtë periudhë të pushimit kur ajo do të skadojë. Pasi të kesh shpenzuar gjithsej 10 vjet në leje të kufizuar, atëherë mund të aplikosh për leje të pacaktuar për të qëndruar.

Albanian Post: Së fundi, duke ju falenderuar zoti Avokat, cila është këshilla ligjore?

Av. Rashid Khan: Nëse jeni duke jetuar në mënyrë të paligjshme në MB si një emigrant ilegal 10 vjet ju mund të ndaleni nga Home Office dhe më pas të deportoheni. Nëse zgjedhni të ktheheni vullnetarisht në vendin tuaj, ju mund të merrni ndihmë për të rregulluar dhe paguar udhëtimin tuaj. Kjo njihet si kthim vullnetar i asistuar. Nëse vendosni të largoheni vullnetarisht, ju mund të aplikoni për t'u kthyer në MB midis 1 dhe 5 vjetëve në varësi të rrethanave tuaja. Nëse jeni deportuar, do t'ju ndalojnë të ktheheni në Britani të Madhe për 10 vjet. Nëse jeni duke u përballur me dëbimin, duhet menjëherë të kërkoni këshilla ligjore.

Pra këshillohuni për mundësitë tuaja. Pjesa ligjore për emigrantët e paligjshëm dhjetë vjet është jashtëzakonisht komplekse, si në Rregullat e Emigracionit ashtu edhe në diskrecionin e Sekretarit të Shtetit. Nëse doni të rregulloni statusin tuaj të imigracionit në Mbretërinë e Bashkuar, veçanërisht si një emigrant ilegal 10 vjeçar, merr këshilla ligjore të specializuara për të shqyrtuar të gjitha opsionet që janë në dispozicion për ju.

KUR TË RESPEKTON SHQIPTARI EMIGRANT

Duket sikur tashmë, më në fund, politika dhe politikanët, në të krahët e qënies emigrant dhe imigrant, kanë filluar të zbusin mendimet dhe të qëndrojnë disi në "krah" të tyre. Kjo duket në një foto të realizuar disa janë më parë dhe të shpërndarë në rrjetet sociale ku dy deputetë të Parlamentit shqiptar, zonja Mimi Kodheli dhe zoti Luan Rama ndodhen në një pritje miqësore të shqiptarëve me punë dhe banim në Londër. kjo në pamje të parë tregon se emigrantët shqiptarë nuk duan të dinë më për krahët e poltikës, por të vlerësojnë dhe respektojnë të gjithë ata që ulen me ta. Asnjë nga këta shqiptarë të mirë, të respektuar dhe punëtorë nukkërkon nga poltikanët të jenë të përkëdhelur. Natyrisht kanë bindjen e tyre, por kanë dhe respektin për ata që i respektojnë. Ata në fakt nuk janë në kërkim të mëshirës. Mëshira për ta është respekti. Mëshira mbetet tek politika, kur ajo duket e ashpër dhe acaruese, shpërfillëse, nxitëse, raciste.

Pak kohë më parë, Papa Françesku, nga Vatikani kërkoi mëshirë për politikanët që nxisin në popull frikën nga emigrantët, duke thënë se po mbjellin dhunë dhe racizëm. Ai i kërkoi atyre që të jenë të kujdesshëm dhe të praktikojnë virtytin e maturisë. Gjatë ritualit të përhershëm nga Vatikani, Papa Françesku kërkoi mëshirë për politikanët që nxisin frikën dhe racizmin kundër emigrantëve. Ai i bëri thirrje që të jenë të kujdesshëm dhe të praktikojnë virtytin e maturisë, për ti ndihmuar emigrantët të integrohen në shoqëri. Papa, e shkëputi komentin mbi mbrojtjen e emigrantëve nga mesazhi i vitit 2018, që iu drejtohej liderve të shteteve, qeverive dhe institucioneve ndërkombëtare në 1 janar të vitit të ri. Mesazhi vjen në një moment kur emigrimi është bërë një çështje e rëndësishme politike për Amerikën, Italinë, Australinë dhe Gjermaninë.

Në Britani të Madhe shqiptarë të shumtë kanë probleme emigrimi. Ata presin zgjidhjen nga qeveria e zonjës May. Në Gjermani, kancelarja Merkel është kritikuar për politikën e dyerve të hapura për emigrantët, duke i shkaktur humbje votash kundrejt partive anti-emigracionit. Ndërsa në Itali, partia anti-emigracion Lidhja e Veriut pritet të fitojë terren në zgjedhjet e ardhshme. Nga ana tjetër, Presidenti Trump ka premtuar ngritjen e murit në kufi SHBA-Meksikë, me qëllim mbajtjen larg të emigrantëve, ky veprim u kritikua nga vetë Papa.

Papa Françesku, thekson se shtetet e pasura duhet të tregojnë një frymë dhembshurie, kundrejt atyre që detyrohen ti ikin nga lufta, uria, diskriminimi, persekutimi, varfëria dhe shkatërrimi mjedisor. Duke praktikuar virtytin e maturisë, liderët qeveritarë duhet të ndërmarrin masa në mikëpritjen, promovimin, mbrojtjen, integrimin në përputhje me vlerat e përbashkëta, për ti lejuar ato të bëhen pjesë e shoqërisë. Dhe këta shqiptarë me mikpritjen e tyre për Kodhelin dhe Ramën duan të shprehin me heshtjen e tyre se pikërisht këtë duan.

Cilët ishin deputetët që ndjenë pritjen e pastër të emigrantëve shqiptarë: Mimi Kodheli ka lindur në Tiranë, më 11 shtator 1964. Kodheli është Doktorante e Shkencave Ekonomike nga Universiteti i Veronës, Itali, në bashkëpunim me Universiteti i Tiranë Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, prej vitit 2007. Ka një Master në Administrim Biznesi nga Universiteti i Lincoln, Nebraska, SHBA, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës prej vitit 2000, si dhe është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Dega Financë në vitin 1986. Mimi Kodheli ka hyrë në politikë në vitin 2002, kur edhe u bë Nënkryetare e Bashkisë së Tiranës. Në vitin 2005, ajo u emërua Prefekte e Qarkut të Tiranës dhe në vitin 2009 u zgjodh Deputete e Kuvendit të Shqipërisë, duke mbajtur pozicionin e Nënkryetares së Komisionit të Ekonomisë dhe Financës përgjatë gjithë legjislaturës. Që prej vitit 2007 e në vazhdim është Anëtare e Kryesisë së Partisë Socialiste. Ajo është trajnuar në fusha të ndryshme si ato të treg-jeve ndërkombëtare dhe të letrave me vlerë, tregjet e punës dhe të investimeve, trajnim për ndërmarrjet të vogla e të mesme, ekzaminim dhe menaxhim bankar. Ajo ka marrë pjesë në një program të Departamentit Amerikan të Shtetit, të titulluar "Gratë në Politikë" si dhe atë të titulluar "Politikat e Sigurisë Kombëtare" nga Qendra Evropiane e Sigurisë, Marshall. Mimi Kodheli në vitin 2013 zgjidhet Ministre e Mbrojtjes e Shqipërisë.

Luan Rama ish-Ministër i Brendshëm i Shqipërisë gjatë periudhës korrik, 2002 - tetor, 2003 të qeverisë socialiste. Nënkryetar i LSI-së. Luan Rama është një nga 140 deputetët e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, dalë nga zgjedhjet e 25 qershorit 2017. përket Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun e Tiranës.

SISTEMI I ARSIMIT TË MESËM

Për studentët ndërkombëtarë që vijnë në Mbretërinë e Bashkuar për arsimin e mesëm

Arsimi i mesëm në Mbretërinë e Bashkuar zakonisht fillon për shumicën e nxënësve në moshën 11 vjeç. Megjithëse jo e zakonshme, në disa pjesë të Britanisë së Madhe ekzistojnë shkolla të mesme që zgjasin deri në 12 ose 13 vjeç.

Për studentët ndërkombëtarë që vijnë në Mbretërinë e Bashkuar për arsimin e mesëm, është e zakonshme që ose të hyni në moshën 11 vjeç ose të prisni deri në moshën 13 vjeç dhe të keni një vit në shkollë përpara se të filloni programin dyvjeçar GCSE, i cili do të zgjasë nga 14 në 16 vjec.

Nga mosha **11-14 vjeç**, studentët do të studiojnë një gamë të gjerë temash si muzika, matematika, shkenca, anglisht, etj. Kur arrini 14, zakonisht hyni në vitin tuaj të parë të një procesi 2 vjeçar të njohur si GCSE (ose SCE për ata që janë në Skoci). GCSE janë një sërë provimesh që testojnë njohuritë dhe aftësitë tuaja. Shumica e shkollave ndjekin të njëjtën metodë kur bëhet fjalë për GCSE dhe ju do të merrni këto lëndë kryesore:
anglisht
mathematikë
Shkencat (Biologjia, Kimia dhe Fizika e kombinuar ose e veçuar)
Nxënësit në mënyrë tipike pastaj zgjedhin **4 ose 5 lëndë të tjera për të marrë GCSE dhe mund të jenë lëndë si: Frëngjisht, Gjermanisht, Studime Biznesi, Dizajn dhe Teknologji, Muzikë, Shkenca Sportive, Gjeografi, Histori dhe shumë opsione të tjera.**

Në shkollat shtetërore, studentët zakonisht marrin 5 deri në 10 GCSE, në varësi të aftësisë dhe nxitjes së studentit. Për shkollat e pavarura, të cilat zakonisht janë më shumë rezultate të nxitura, nuk është e pazakontë që studentët të marrin sa më shumë 11 ose 12, duke u fokusuar më shumë në lëndët akademike krahasuar me lëndët e artit.

GCSE merr një total prej 2 vjetësh dhe shënon fundin e arsimit të detyrueshëm për studentët në MB. Sapo të kenë përfunduar studentët e GCSE-së, atëherë zgjedhja për t'u zhvendosur në arsimin e mëtejshëm (me qëllim të arsimit të lartë) ose mund të largohet nga shkolla dhe të kërkojë punë.

KËRKESAT E HYRJES -rregjistrimit
Çdo nivel i arsimit në Mbretërinë e Bashkuar ka kërkesa të ndryshme të cilat duhet të jenë të kënaqur për të fituar hyrjen në atë nivel - të mësojnë më shumë rreth kërkesave të hyrjes në arsim për Mbretërinë e Bashkuar.

Kërkesat e hyrjes për të studiuar në Mbretërinë e Bashkuar
Varësisht nga programi që po kërkoni, kërkesat e hyrjes do të ndryshojnë për studentët ndërkombëtarë. Edhe pse kjo faqe do t'ju japë disa informata të dobishme me të cilat do të vendosni veten në lidhje me atë që është e nevojshme për të fituar hyrjen në kurset e Mbretërisë së Bashkuar, duhet të pyesni në mënyrë specifike për çdo kurs që po shqyrtoni. Çfarë do të gjeni të përbashkët në të gjitha kurset dhe shkollat është se do t'ju duhet të tregoni kompetencën në gjuhën angleze.

Gjuhe angleze
Për shumicën e shkollave dhe kurseve, niveli juaj i të kuptuarit dhe kompetencës në anglisht do të jetë kyç për pranimin tuaj në një program të madh si një program shkolle. Ju do të duhet të siguroheni që keni një nivel të mirë të kuptimit të anglishtes dhe mund ta bëni këtë duke marrë një nga testet e pranuara në përgjithësi të aftësisë angleze:
TOEFL - Test i gjuhës angleze si gjuhë e huaj
IELTS - Sistemi Ndërkombëtar i Testimit të Gjuhës Angleze
UCLES - Sindikata e provimeve lokale të Universitetit të Cambridge

Nëse keni nevojë për ndihmë me gjetjen e një gjuhe angleze si gjuhë e dytë (ESL School), ju lutemi shikoni dosjen ESL për një listë të plotë të shkollave në mbarë botën.

KËRKESAT E HYRJES NË GCSE

Këto rregulla zbatohen vetëm për studentët nga vendet jo anëtare të BE

Hyrja për marrjen e GCSE-së do të varet shumë nga shkolla me të cilën po ndjekni, pasi zakonisht duhet të regjistroheni me një shkollë për vitet e arsimit GCSE (14 deri në 16 vjeç). Përveç kërkesave të shkollës, kërkesat kryesore nga bordet e provimeve në Mbretërinë e Bashkuar janë se ju keni një nivel të mirë të aftësisë angleze, pasi që provimet do të merren në gjuhën angleze - shih kërkesat në anglisht më lart.

Kërkesat e hyrjes në nivel A

Ashtu si me GCSE-në, do të jetë shumë e varur nga shkolla që dëshironi të merrni pjesë në atë se cilat janë kërkesat për të studiuar A-nivelet atje. Për shembull, një kolegj i formuar i 6-të mund të kërkojë që të keni së paku 5 gradë të klasës C ose më lart, krahasoni këtë me një shkollë të pavarur, e cila mund të kërkojë 10 gradime të GCSE të B ose më lart. Pra, kjo do të varet shumë nga shkolla. Ju gjithashtu duhet të konsideroni se A-nivelet janë një nivel shumë më i lartë i punës dhe kështu një kuptim shumë i mirë i gjuhës angleze do të nevojitet për të punuar në këtë nivel. Disa njerëz thonë se nivelet e A-së janë më të vështira se shumica e programeve të gradave, pasi ata ju përgatitin për arsimin e lartë.

Kërkesat e hyrjes në kursin profesional

Ashtu si me GCSE-në, në përgjithësi nuk do të keni nevojë për ndonjë kualifikim formal për të hyrë në kursin bazë të profesionit. Aftësitë e shkrim-leximit dhe aftësia në gjuhën angleze do të ishin të vetmet kërkesa, por përsëri duhet të kontrolloni me shkollën ose institucionin që po drejton programin pasi që ato mund të kenë kërkesat e tyre.

VIZA STUDENTORE DHE EMIGRACIONI

Ashtu si me SHBA-të, hyrja në Mbretërinë e Bashkuar po bëhet gjithnjë e më e vështirë kur qeveria shtrëngon kontrollet kufitare dhe ka kërcënime të vazhdueshme të aktiviteteve terroriste. Procedurat më të rrepta ndikojnë të gjithë, por nuk duhet të pengojnë ju nëse dëshironi të vini në Mbretërinë e Bashkuar.

Më 1 shtator 2007, kërkesat e reja të vizave për studentët hynë në fuqi në Mbretërinë e Bashkuar. Sipas rregullave të vjetra, shumica e studentëve nuk kishin nevojë për vizë dhe nëse do të studionim për më shumë se 6 muaj, duhej vetëm të merrnim lejen e hyrjes. Sipas rregullave të reja, ekzistojnë dy kategori vizash studentore, dhe shumë studentë më shumë se më parë do të kenë nevojë për viza. Studentët ndërkombëtarë që kanë hyrë në Mbretërinë e Bashkuar para 1 shtator sipas rregullave të vjetra gjithashtu do të duhet të respektojnë rregullat e reja nëse ata largohen dhe duan të kthehen. Studentët nga vendet jo-anëtare të BE-së sikurse është Shqipëria Këtu kemi një pasqyrë të shkurtër të rregullave të reja për Vizitorin e Vizitorëve të Studentëve (më pak se 6 muaj) dhe Viza Studentore / Hyrja Para Hyrëse (më e madhe se 6 muaj). Këto rregulla zbatohen vetëm për studentët nga vendet jo anëtare të BE. Vizitori studentor - viza vizitori studentor është për ata që planifikojnë të qëndrojnë më pak se 6 muaj.

Nën vizën e Vizitorit të Studentit, një student nuk mund të ketë paguar punësim ose stazh më të madh se 2 orë kreditore dhe nuk mund ta zgjasë qëndrimin e tyre sapo të mbërrijnë. **Viza Studentore / Pranimi paraprak i hyrjes - nëse planifikoni të qëndroni në Britani të Madhe për më shumë se 6 muaj, nëse mund të zgjasni për më shumë se 6 muaj ose nëse dëshironi të punoni ose të keni një praktikë më të madhe se 2 orë krediti atëherë duhet të aplikoni për një vizë studentore / hyrje paraprake hyrëse.**

APLIKIMI PËR NJË VIZË STUDENTORE

Ju duhet të aplikoni për vizë vizitorësh studentore, vizë studentore dhe parapagesë hyrëse përpara se të largoheni nga vendi juaj. Nëse nuk e bëni, ju rrezikoni të largoheni në mbërritje nëse nuk keni të gjitha dokumentet dhe informacionet e duhura. Në përgjithësi, për të aplikuar për një vizë studentore juve ju nevojitet:

Të pranohen dhe të regjistrohen në një kurs të njohur me kohë të plotë, ose Një kurs i drejtuar gjatë javës që përfshin të paktën 15 orë të studimit të organizuar ditor çdo javë, ose Një kurs me kohë të plotë në një shkollë të pavarur të pagimit të taksave

Ju gjithashtu duhet të: **Të jeni në gjendje të paguani për kursin tuaj dhe të përkrahni veten dhe çdo person që jeni të varur dhe jetoni në Britani të Madhe pa punuar ose keni nevojë për ndonjë ndihmë nga fondet publike, Keni mundësi dhe synoni të ndiqni kursin tuaj të zgjedhur dhe Doni të largoheni nga Britania e Madhe kur të përfundoni studimet tuaja.** Punë pas përfundimit të studimeve

Ashtu si Shtetet e Bashkuara, studentët që kryejnë një program në Angli lejohen të aplikojnë për një zgjatje njëvjeçare të vizës së tyre për t'i lejuar ata të fitojnë përvojë pune në Britani të Madhe, pa pasur nevojë të marrin një leje pune. Studentët që studiojnë në Skoci janë tani në gjendje të zgjerojnë vizat e tyre dhe të punojnë për dy vjet pas përfundimit të një diplome në një universitet skocez, duke ndihmuar që Skoci të jetë një destinacion veçanërisht tërheqës për studentët ndërkombëtarë.

ROLI I GJUHËS SHQIPE PËR FËMIJËT E MËRGIMTARËVE

Nga Fran Gjoka

Emigracioni, gjatë gjithë periudhave të historisë, ka qenë dhe është një fenomen tipik social me karakter ndërkombëtar. Edhe Shqipëria në këtë aspekt nuk ka bërë dhe as nuk bën përjashtim. Periudha e vështirë e tranzicionit u shoqërua me një hemorragji të pandalshme të procesit të emigrimit të popullsisë së vendit tonë, sidomos në drejtim të vendeve perëndimore, në kërkim të kushteve më të mira të jetesës, sigurisë për të ardhmen dhe kualifikimit arsimor të fëmijëve. Pra, emigrimi i popullsisë në përgjithësi dhe i fëmijëve në veçanti, krahas anës pozitive, mbart me vetvete edhe rrezikun e një fuzioni apo asimilimi gradual të gjuhës sonë shqipe, sidomos tek fëmijët dhe tek rinia shqiptare që jeton aktualisht në mërgim. Fatet ekzistuese të një kombi përcaktohen në fund të fundit nga gjuha dhe kultura e tij. Popullsia e një vendi, që për arsye të ndryshme nuk e shkruan dhe rrallë herë e flet gjuhën e tij amtare, është i prirur të rrezikohet, pasi gjuha ka qenë dhe mbetet një ndër komponentët kryesorë të kulturës së një kombi. Kur njeriu nuk e ka nën këmbë tokën e vet, humbet diçka nga qëndrimi i tij vertikal, humbet sigurinë dhe në shumë raste bëhet më skeptik ndaj vetvetes. Është interesant fakti se gjuha shqipe ka një zhdërvjellësi në të folur, është shumë burrërore dhe mjaft e bukur. Këtë e kanë vënë re edhe mjaft albanologë dhe gjuhëtarë, të cilët kanë vënë re se kur dëgjohet e folura e shumë vendeve të Europës, duke krahasuar me shqipen, gjuha jonë ka një tingull të veçantë dhe mjaft impulsive. Kjo ndodh sepse shqipja është vazhdim i gjuhës ilire dhe i përket grupit të gjuhëve Indo – Europiane pra, veçohet si një nga më të vjetrat në Europë dhe Ballkan. Është detyrë imperative e mësuesve atdhetarë shqiptarë për t'u mësuar dhe shkruar gjithnjë shqipen brezave të fëmijëve emigrues e shoqëruar me një përkushtim në hapjen e shkollave të reja në gjuhën shqipe. Shqiptarë të vërtetë, patriotë dhe atdhetarë ka plot, si ata që dërguan libra, hapën shkolla, hartuan programe, mësues që punojnë me devotshmëri për vite me radhë jashtë Shqipërisë, nuk mungojnë. Këtu më vjen në mend një thënie e një emigranti me banim në Itali, i cili, kur ra fjala për gjuhën e nënës, më pati thënë: "…Gjuha është e vetmja armë që vërteton se ne jemi shqiptarë kudo që ndodhemi…". Parë nga ky këndvështrim, përfitoj nga rasti t'u bëj thirrje mësuesve atdhetarë, prindërve emigrantë, që t'u mësojnë fëmijëve si ta flasin dhe të shkruajnë pa ndërprerje shqipen, gjuhën që të parët tanë na e lanë për ta përdorur përgjithmonë të pastër.

Historikisht mërgimtarët shqiptarë kanë punuar, kanë jetuar dhe janë përpjekur që fëmijëve të tyre t'ua mësojnë dhe ta ruajnë gjuhën shqipe. Kjo traditë e çmuar, si amanet i rëndë i të parëve tanë, "që s'e tret dheu i huaj", deri në ditët tona, duhet të ruhet. Hemorragjia e pasviteve '90 të shekullit të kaluar, që ka bërë tashmë të shpërngulen nga atdheu, për një jetë më të mirë, me gjithë familjen, me djem dhe vajza mjaft familje shqiptare, ka detyruar mërgimtarët shqiptarë, këtej e matanë kufijve shtetërore, që t'iu përshtaten kërkesave të reja të epokës së globalizimit, ku është bërë eminent rreziku i humbjes së kulturave nacionale, pra edhe të gjuhës nga breznitë e reja. Është për t'u theksuar se tashmë për fëmijët e mërgimtarëve janë hapur shkolla të shumta në vende të ndryshme, ku fëmijët marrin në mënyrë të organizuar mësim e plotësuese në gjuhën amtare nga mësues patriotë e pasionantë, të cilët, në të shumtën e rasteve, e japin ndihmën e tyre vullnetarisht. Shembujt janë të shumtë dhe gjendja e këtyre shkollave, mund të themi se përfshin hapësira të reja, ku jetojnë e punojnë shqiptarët emigrantë. Në përgjithësi për çeljen dhe mbarëvajtjen e këtyre shkollave, kanë dhënë ndihmën e tyre dhe drejtuesit e pushtetarët lokalë si në qytetet Nju Jork, Bruksel, Hamburg, Berlin, Frankfurt, Oslo, Athinë etj. Është pozitiv fakti se në shumë qytete në Amerikë, aty ku komunitetet shqiptare janë të organizuar, janë ngritur dhe funksionojnë shkolla dhe kurse në gjuhën shqipe. Po kështu në Kanada janë hapur shkolla shqipe. Në Europë ka shembuj pozitivë të funksionimit të këtyre shkollave si në Angli, Zvicër, Gjermani, Suedi, Itali etj., ku funksionojnë shkolla të hapura nga vetë shqiptarët, sidomos nga ata të Kosovës dhe të trojeve të tjera ku jetojnë shqiptarë. Synimi i këtyre vendeve dhe shkollave mbetet i qartë: fëmijët e mërgimtarëve të zotërojnë mirë shkrim – lexim në gjuhën amtare shqipe, ta kultivojnë atë dhe letërsinë shqipe, të njohin historinë dhe gjeografinë etnike të vendit të të parëve, si dhe artin, kulturën dhe traditat kombëtare. Rëndësi e veçantë, në këto shkolla shqipe u kushtohet veprimtarive të lira jashtë klase, si puna me librin, funksionimi i bibliotekave, konkurse dhe biseda për librin etj. Në ekranet televizive kemi dëgjuar cicërimat e bukura, emocionale dhe krenare të fëmijëve shqiptarë në gjuhën e bukur amtare, në tubime të tyre, të prindërve dhe të komunitetit. Vërtetë jetojmë në një shoqëri të lirë e të hapur, vërtetë jemi përkrahës të globalizimit dhe të rejave që po hyjnë në shkencë dhe teknikë, por nuk do të dëshironim kurrë që gjuha jonë e bukur të mos shkruhej e të përdorej nga shqiptarët e të gjitha brezave që do të vijnë. Mundësitë për ta mbajtur të gjallë gjuhën e bukur shqipe, gjuhën e Naimit tek fëmijët, nipërit, mbesat dhe stërnipërit tanë, pavarësisht se ku lindin e ku jetojnë ata, janë evidente. Ata pavarësisht nga mjedisi i huaj ku jetojnë e punojnë, nga rrethanat aspak favorizuese për të përdorur gjuhën shqipe, askush nuk i pengon të flasin vetëm shqip në familje, të komunikojnë me fëmijët e tyre vetëm përmes gjuhës sonë amtare. Fjala vjen, të mos na duket vetja modern kur në çdo fundjavë me familjen kalojmë në njërin prej lokaleve angleze, italiane, gjermane, greke të mos fyhemi nëse flasim në ambiente të tilla familjare në gjuhën tonë të bukur.

DASHAMIRËSIA E VULLNETARËVE TË DREJTUAR NGA DR ZAMIRA RUSPI

Shoqata kreu me sukses regjistrimet për vitin e ri 2018 në shkollën shqipe "Mother Teresa Albanian Union"

"Mother Teresa Albanian Union" filloi Vitin Shkollor Akademik 2018 -2019. Shkolla Supplementare Shqipe filloi 15/9/2018, ora 11am. Shoqata kreu me sukses regjistrimet për vitin e ri 2018 në shkollën shqipe "Mother Teresa Albanian Union". Kjo shoqatë ka tashmë një përvojë të madhe në arsimin plotësues të ndertuar sipas ligjeve dhe rregulloreve të Britanisë së Madhe. Arsimi plotësues i "Mother Teresa Albanian Union" mund të përkufizohet si të gjithë të mësuarit jashtë orarit të shkollës, sidomos në të shtunat e javëve të cilat mblidhen në Neëman Chatholic School në zonë e Brentit. Veçanërisht klasat e kësaj shkolle plotësuese të drejtuar nga mësuese mjaft të kualifikuara, janë përqendruar në ofrimin e mbështetjes shtesë për lëndët e kurrikulit duke përfshirë të gjitha gjuhët, historinë dhe aktivitetet e pasurimit kulturor si besimi, artet dhe sporti. Sigurimi kryhet brenda një sërë kontekstesh duke përfshirë: Grupet e shkollimit, Klubet pas shkollës, Shkollat plotësuese, Orët e gjuhës amtare, Shkollat plotësuese, Shkolla e së shtunës, e aktivitete të tjera socio-kulturore. Shkollat plotësuese të "Mother Teresa Albanian Union" ofrojnë këtë gamë të mbështetjes arsimore (gjuhë, kurrikulë bërthamore, dhe kulturë) jashtë ditës së shkollës dhe brenda kontekstit të një bashkësie të veçantë etnike, kombëtare. Ato krijohen dhe menaxhohen nga anëtarë të komunitetit, në përgjithësi në baza vullnetare. Si organizata të bazuara në komunitet ata veprojnë si informata dhe pika të rëndësishme për të rriturit si dhe për fëmijët. Duhet thkesuar se shkollat e "Mother Teresa Albanian Union" janë brenda tërë faktit se në Angli ekzistojnë 3.000-5.000 shkolla të tilla. Dashamirësia e vullnetarëve të drejtuar nga Dr Zamira Ruspi, stafi i saj dhe Kryetari i Bordit, biznesmeni, Aqif Neli, është në ballë të mbështetjes për shkollat plotësuese dhe beson se ato janë një mjet i rëndësishëm për të kanalizuar mbështetjen e drejtpërdrejtë në një shumëllojshmëri aktivitetesh. Kjo dashamirësi ka arritur shumë pjesë të punës që eksplorojnë dhe mbështesin komunitetin, si kualifikimet e aststeve të mësuesisë etj. "Mother Teresa Albanian Union" ka përfunduar një numër studimesh rastesh që tregojnë një varg modelesh për financimin relativisht të qëndrueshëm të shkollave plotësuese. "Mother Teresa Albanian Union" gjithashtu ka publikuar një raport mbi karakteristikat e nxënësve të shkollave plotësuese dhe arritjet e tyre arsimore në shkollën e saj. "Mother Teresa Albanian Union" dhe stafi i kualifikuar kanë përfunduar dhe paraqitur ndihma mbi shkollat plotësuese dhe rëndësinë e rolit të tyre në përmirësimin dhe mbështetjen e rezultateve arsimore të shkollave shqipedhe fëmijëve dhe të rinjve të pafavorizuar. "Mother Teresa Albanian Union" është një organizatë tashmë strategjike dhe model për shkollat suplementare të udhëhequra nga komuniteti dhe për sektorin e arsimit plotësues në të gjithë komunitetin shqiptar. "Mother Teresa Albanian Union" njihet për përsosmëri, inovacion dhe partneritet në arsimin plotësues. "Mother Teresa Albanian Union" angazhohet në emër të shkollave plotësuese dhe studentëve, tutorëve dhe udhëheqësve të tyre. "Mother Teresa Albanian Union" synon të ndihmojë në rritjen e profilit të shkollave plotësuese dhe standardeve të tyre të mësimdhënies, mësimit dhe menaxhimit.

FILOZOFIA E “KLIENTIT TË PARË” ËSHTË MË SHUMË SE NJË FRAZË

Ajo është mënyra e të bërit biznes tek “Big Boss Services UK Ltd”

Furgoni që shihni në foto është thuajse zyra e tij e punës. Aty ai ka mjetet dhe të gjitha materialet. Është aq modest, i thjeshtë dhe a qi kërkuar në të gjitha pikat ku banorët vendas dhe të tjerë kanë arsyen të thërrasin kompaninë që ai drejton “Big Boss Services UK Ltd”. Kjo komani në një shikim të parë dhe në një ditë pranë saj me të gjithë angazhimin e saj bën thuajse mrekulli. Mjaft vetë që takuam na thonë se ajo i bën vjetërsirat të flasin me gjuhën e së resë, me modernen dhe më jetiken. Ndërton thuajse nga e para orenditë e nevojshme dhe pikturon brenda dhe jashtë tyre mrekullisht, duke bërë kështu që të ketë me dhjetëra lavdërime nga të gjithë klientët e saj. Në Hackney mjaft mjedise familjare kanë firmën e “Big Boss Services UK Ltd”. Pronari i kësaj kompanie Gazmend Cufaj na thotë: “Kuptimi i qëllimeve të klientëve tanë dhe integrimi i tyre në operacione ka qenë çelësi i rritjes sonë të qëndrueshme. Ndërsa kompania jonë zgjerohet, angazhimi ynë primar mbetet i pandryshuar: klientët tanë janë prioriteti ynë i parë. Ne jemi krenar që pjesa më e madhe e punës sonë është rezultat i klientëve të përsëritur, duke konfirmuar se filozofia jonë e “klientit të parë” është më shumë se një frazë - është mënyra jonë e të bërit biznes.” Më tej ndërsa ne interosohemi për përditësinë e kompanisë ai shprehet se “Ne përdorim teknologjinë më të fundit për të menaxhuar projektet tona duke përfshirë më të domosdoshmet. Klientët e tanishëm mund të klikojnë në logon e komanisë sonë për të hyrë në informacionin e projekteve tona”. Sot, Pronarët janë të sfiduar me projekte gjithnjë e më komplekse dhe burime të kufizuara. Menaxherët tanë të ndërtimit ndihmojnë pronarët që tejkalojnë këto sfida duke shtuar burimet e pronarit me zgjidhje inovative dhe profesionistë ndërtimi të talentuar. Klientët i kuptojnë përfitimet e dhënies së projekteve komplekse të ndërtimit në “Big Boss Services UK Ltd”. sepse besojnë tek: Cilësia, profesionalizmi dhe përvoja, që janë përbërësit kyç për realizimin e projekteve në kohë dhe brenda buxhetit. Kërkesat e mundshme shmangen përmes kontratave të qarta dhe dokumentacionit të detajuar. Operacionet në terren vazhdojnë normalisht përmes planifikimit të integruar dhe menaxhimit të burimeve. Masat e sakta të progresit sigurohen nëpërmjet buxhetit në kohë dhe raporteve të statusit të orarit. Të gjithë e kuptojnë “paqen e mendjes” me një përfaqësues që mbron interesin e tyre gjatë gjithë zhvillimit të projektit.

Ekipi i “Big Boss Services UK Ltd” ka njohuri, përvojë dhe trajnim të specializuar për të lundruar nëpër kompleksitetin e çdo programi apo projekti ndërtimi. Duke siguruar resurset dhe ekspertizën e nevojshme për menaxhimin e cilësisë, kostos, planifikimit, fushëveprimit dhe rreziqeve që lidhen me ndërtimin, ata arrijnë objektivat e klientëve duke u dhënë atyre kontrolle më të mira të projekteve.. “Big Boss Services UK Ltd” ka fituar një reputacion lokal për të ndihmuar klientët e saj.

EMIGRACION: AMNISTIA PËR EMIGRANTËT E PALIGJSHËM QË KANË QENË NË MB PËR 10 VJET

Ky peticion bën thirrje për emigrantë të paligjshëm që kanë qenë në MB për 10 vjet ose më shumë për t'u dhënë amnisti dhe të drejtën ligjore për të qëndruar në MB.

Peticioni i organizuar nga Steve Parker thotë se vetëm në 100,000 nënshkrime, ky peticion do të shqyrtohet për debat në Parlament. Deri tani janë realizuar 44,748 nënshkrime. Në disa komunikime me letra thuhet se "Qeveria u përgjigj". Kjo përgjigje është dhënë më 6 qershor 2018. Përgjigjja është si më poshtë, sipas Home Office: "Nuk ka plane për të dhënë amnisti për migrantët e paligjshëm. Politikat tona të imigracionit bazohen në parimet e drejtësisë ndaj migrantëve të ligjshëm dhe nuk i shpërblejnë ata që nuk respektojnë Rregullat". Lexoni përgjigjen në mënyrë të plotë: Qeveria nuk beson se futja e një amnisti të plotë për emigrantët e paligjshëm që dëshirojnë të rregullojnë statusin e imigracionit do të ishte qasja e drejtë. Ajo do të shpërblejë paligjshmërinë, do të dëmtojë Rregullat e Emigracionit për të aplikuar për leje për të hyrë ose për të qëndruar, të cilat Parlamenti ka miratuar dhe do të ishte i padrejtë për ata emigrantë që vijnë legalisht në MB dhe të respektojnë kushtet e emigracionit. Ajo gjithashtu mund të inkurajojë më shumë migrantë që të përpiqen të hyjnë ose të qëndrojnë në vend ilegalisht me shpresën se do të trajtohen në mënyrë të ngjashme. Ky rrezik shtesë për të inkurajuar migrimin e mëtejshëm të paligjshëm mund të rrezikojë individët dhe familjet e tyre duke i vendosur ato në duart e trafikantëve të paskrupullt. Rregullat e Imigracionit janë dizajnuar të jenë të drejta dhe t'i trajtojnë njerëzit me respekt dhe dinjitet, por edhe të vendosur me ata që nuk i përmbahen Rregullores dhe që sigurojnë që njerëzit të vijnë në Britani të Madhe për arsye të drejta - të punojnë shumë dhe të kontribuojnë në punën tonë ekonomisë dhe shoqërisë.

Është e rëndësishme që të bëjmë dallimin midis atyre që janë këtu ligjërisht dhe atyre që janë këtu në mënyrë të paligjshme. Ne i njohim pasojat shkatërruese që migracioni i paligjshëm mund të ketë tek individët që bëhen të ekspozuar ndaj shfrytëzimit. Ne jemi të përkushtuar për të trajtuar grupet e krimit të organizuar që përfitojnë nga migracioni ilegal dhe për mbrojtjen e atyre që janë në rrezik të shfrytëzimit. Ka rrugë të disponueshme për individët të cilët besojnë se kanë të drejtë të qëndrojnë në MB në bazë të jetës familjare ose private, ose baza të tjera të të drejtave të njeriut. Ata që duan të mund të aplikojnë sipas Rregullave të Emigracionit dhe çdo aplikim konsiderohet rast pas rasti, duke marrë parasysh rrethanat individuale. Është e rëndësishme që të ketë stimuj të qartë për të përmbushur Rregullat e Imigracionit. Kjo do të thotë, për shembull, që jeta private e themeluar këtu, ndërsa një person është në MB në mënyrë të paligjshme ose ndërsa statusi i tyre i imigracionit është i pasigurt, duhet t'u jepet pak peshë. Detajet e plota mund të gjenden në GOV.UK duke kërkuar për Shtojcën FM 1.0b Jeta Familjare (si Partner ose Prind) dhe Jeta Private: Udhëtime 10-vjeçare këtu: ëëë.homeoffice.gov.uk. Balancimi i të drejtës individuale për respektimin e jetës private ose familjare me interes publik për të mbrojtur mirëqenien ekonomike të Mbretërisë së Bashkuar duke kontrolluar imigracionin është një objektiv legjitim. Në të njëjtën kohë, ne i njohim disa njerëz që mbërritën në Mbretërinë e Bashkuar shumë vite më parë dhe nuk kanë dokumente që konfirmojnë statusin e imigracionit. Ata janë përballur me vështirësi në vërtetimin e të drejtës së tyre për punë, për të marrë me qira pronën dhe për të përfituar përfitime dhe shërbime për të cilat kanë të drejtë. Qeveria ka kërkuar falje për njerëzit në këtë pozitë dhe ka bërë një angazhim për t'i ndihmuar ata të marrin dokumentet që u nevojiten. Më 16 prill, një grup pune u krijua për të bërë marrëveshje të menjëhershme për të ndihmuar ata që kishin nevojë për të. Kjo përfshinte krijimin e një linje ndihme për të kontaktuar me Home Office. Më 24 maj, sekretari i ministrisë njoftoi skemën e Windrush për ta bërë më të lehtë për njerëzit që të kenë mbështetjen që ata kanë nevojë. Ata që aplikojnë në këtë Skemë do të përfitojnë nga shërbimet e Taskforce që do të ndihmojnë njerëzit të lundrojnë në sistemin e emigracionit dhe do të vazhdojnë të marrin një qasje simpatike dhe proaktive kur zgjidhin aplikimet. (Home Office)

TË GJITHË EMIGRANTËT JANË PËRBALLUR ME KULTURËN KU KANË SHKUAR

Emigracioni në vetvete përmban lëvizje demografike të popullsisë

Nga Klaudia Malaj

Emigracioni është një ndër temat më aktuale, jo vetëm në këto moment, por vitet e fundit në historinë e Shqipërisë. Nga studiuesit nuk është shfaqur si problematikë para hyrjes së demokracisë.

Emigracionin ta trajtojmë si fenomen shqiptar. Ju si psikologe, ç'mund të na thoni Fatlinda?

Emigracioni në vetvete përmban lëvizje demografike të popullsisë, duke u shpërngulur nga një vend në tjetrin për çfarëdolloj arsye, ekonomike, sociale apo politike. Emigracion ishte nëpërmjet ambasadave. Më pas janë ndjekur procedurat legale nëpërmjet bashkimeve familjare dhe sipas politikave të vendit mikpritës.

A ngjason emigracioni ynë me atë të vendeve arabe?

Mund të bëjmë krahasimin për arsyen pse ndodh emigracioni. Vendet arabe i krahasojmë me emigrimin e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1998-1999, vite që ishin nën presionin e luftës. Shtypja nga një shtet tjetër apo luftërat civile, që ndodhin brenda një shteti janë faktorët përcaktues që popullsia të marrë masa radikale për t'u larguar nga vendi. Aktualisht në vendin e tij. Është një aktualitet i përgjithshëm i atij që është atje dhe atij që është kthyer dhe thjesht e kujton.

Cilat janë pasojat që sjell emigracioni në shoqëri, duke e marrë në aspektin që ka njerëz që shesin gjithçka, thjesht për t'u larguar dhe më pas përballen me një terren të vështirë dhe kur kthehen s'kanë ku të qëndrojnë?

Për sa u përket problematikave, normalisht një fenomen s'prek vetëm individin, por dhe familjen, që ka ndarje, humbje, mall midis tyre. Problematikat marrin përmasa më të gjera, tashmë shoqërore.

mirëmenaxhuara në vendin tone. Përse të mos zbatojmë në resurset e vendit tonë dhe t'i gjejmë në vendin tonë ato që kërkojmë atje? Pra, kemi një lloj demoralizimi për vendin tonë. Një fëmijë në emigracion

Çfarë shqetësimi krijon tek fëmija një vend i huaj, kur pak vite është mësuar në Shqipëri dhe më pas detyrohet të largohet kundër dëshirës së tij?

Kjo është një nga gjërat më të dhimbshme që sjell emigrimi. Fëmijët shkëputen pa dëshirën e tyre nga një ambient i sigurt tashmë ku janë rritur dhe mësuar me gjyshërit,

ka pasur që në lashtësi. Emigracioni është fenomen i lindur me njerëzimin. Megjithatë, studiuesit e kanë ndarë për Shqipërinë në 3 faza. Faza e parë, deri në vitin 1944, ku emigrimi ishte i fokusuar në vendet e largëta si Amerika. Faza e dytë kaloi në një izolim politik, ndërsa faza e tretë është ajo e demokracisë, pra pas vitit 1990. Deri në vitin 1944, shquhej një dyndje e madhe. Kjo gjë u ripërsërit pas vitin 1990. Vitet 1990-1996 kaluan në një dyndje më të madhe, sidomos në Greqi dhe Itali. Më tepër ishte emigracioni ilegal, pavarësisht se një pjesë e tyre s'e krahasojmë emigracionin shqiptar me atë arab, sepse shqiptarët largohen më tepër prej shkaqeve ekonomike, formimit të tyre arsimor dhe mundësive më të mira. Kurse në vendet arabe e shohim prej mungesës së kushteve.

Sa ndikon në jetën e të emigruarit emigracioni?

Emigracioni ka qenë boshti qendror që i ka dhënë drejtim jetës së tyre. Kemi emigrantë që janë kthyer pasi kanë marrë atë që kanë dashur ose jo. Emigracioni mund të ketë mbetur si një eksperiencë tashmë dhe jeta vazhdon

A ndikon kjo në plakjen e popullsisë shqiptare?

Patjetër. Ka ndikuar tashmë. Vihen re ndryshime në statistika për sa i përket këtij fenomeni. Më parë kemi pasur % të lartë të zonës së re në Shqipëri. Tashmë ka ndryshuar. Nëse shifrat 25-28 % kanë qenë mbizotëruese në Shqipëri, tani kemi një % deri në 31-32. Problematika të tjera të emigracionit janë edhe ato sociale. Vendet e zhvilluara janë më atraktive, përderisa i tërheqin emigrantët. Të mos harrojmë se ne ndjejmë atraksion për disa burime të

familjarët dhe shoqërinë dhe ndihen mirë dhe komfort në këtë vend, duke shkuar në një vend ku s'njohin as gjuhën. Por, fëmija i përshtatet stadit të tij të zhvillimit. Fëmija ka një avantazh, që është më i predispozuar të adaptohet në kushtet e reja më shume nga i rrituri. Këtu duhet vërtet një kujdes nga ana e prindërve, që fëmija të socializohet në mënyrë të përshtatshme, që të mos i mbesin pasoja afatgjata. Fëmijët kanë treguar që e kanë gjetur gjuhën e tyre. Janë të rralla rastet që kanë çuar në lloj izolimi.

SPECIALISTJA QË MËSOI NË STAMBOLL

E respektuar tek “Vila Ronel”

Specialistja e kulinarisë shqiptare tek Vila Ronel është mjaft modeste. Shqiptarja që dallon në profesionalizmin e saj. Specialistja, shqiptarja e nderuar dhe mjaft e respektuar si në punë ashtu dhe në komunitet, Eva, mësoi specialitet e shumta në Stamboll, po aq dhe në jenë e saj, dhe u bë specialiste për gatime ëmbëlsirash dhe të tjera që kanë në thelb brumëra dhe asortimente të tjera! Gatimin e pefeksionoi në Stamboll. Ajo mbahet në gojët e komunitetit si modeli për gatimin e byrekëve të ndryshëm, dhe ëmbëlsirave të ndryshme.

Ja si i përgatit ajo:

REVANI

Bashkojmë sheqerin me gjalpin per 6-8 minuta me shpatull druri. Duke e punuar hedhim vezet dhe cipen e limonit ose te portokallit te kruar ne rende. Shtojme simigdalin, miellin dhe soden e bukes. Brumin e perftuar e kthejme ne nje tave ku kemi shtruar nje leter dhe e hapim ne menyre qe peta te mos jete me e trashe se 4-5cm. Brumin e pjekim per 40-50 minuta ne nje furre mesatare. E heqim nga tava duke e kthyer permbys. Heqim letren, e leme te ftohet dhe e veme perseri ne tave.E presim ne copa drejtkendeshe ose romb. Ne nje tenxhere hedhim ujin, sheqerin dhe e leme te valoje sa te behet shorop. E leme pak te ftohet dhe e hedhim mbi revani deri sa te pije.

normativa per 6-8 persona:

Sheqer 100 gr,
Miell 200 gr,
Veze 5 kokrra,
Simigdal 100 gr,
gjalpe 200 gr,
sheqer per shurupin 550 gr,
uje 720 gr,
sode luge kafe,
limon ose portokalle 1 kokerr.

“MESSI ALPIN” DO TË SHKOJË NË BEOGRAD ME LIVERPOOLIN?

Nga “Goal.com”

“Goal.com” përmes një shkrimi në faqen e saj jep të gjitha arsyet se pse Xherdan Shaqiri nuk do të udhëtojë me ekipin e tij të ri, **Liverpool,** në udhëtimin e **6 nëntorit në Beograd** ndaj **Crvena Zvezdas**, ndeshje e vlefshme për Grupin C të Ligës së Kampionëve. Xherdan Shaqiri bashkë me Taulant Xhakën ishin në qendër të polemikave gjatë Kupës së Botës së kësaj vere, pas festimit të tyre me “shqiponjë” në dy golat që shënuan ndaj Serbisë. Festim ky i cili u interpretua si një veprim provokim politik nga ana e serbëve. Shaqiri ka lindur në Kosovë, një shtet që e ka shpallur pavarësinë nga Serbia në vitin 2008, megjithëse kjo e fundit nuk e njeh. Për këtë arsye, festimi i Shaqirit kishte pasoja politike të diskutueshme, jashtë fushe.

Festimi i Shaqirit dhe Xhakës që ‘çmendi’ serbët

Megjithatë, Liverpooli mund të tregojë kujdes dhe të vendosë kundër grumbullimit të tij në skuadrën që do të udhëtojë drejt Serbisë, pasi tensioni politik dhe pritja potencialisht e rënduar mund të jenë shumë të diskutueshme.

Drejtori sportiv i Crvena Zvezdas, Zvezdan Terzic, zbuloi se klubi i tij do të bëjë detyrën për të mbrojtur Shaqirin, së bashku me Liverpoolin, megjithëse theksoi ndikimin e situatës. Drejtori gjeneral i Zvezdas: Shaqiri do të jetë nën presion të madh se e di ku po vjen, por ne duhet ta mbrojmë në rast të situatave të padëshirueshme

Drejtori gjeneral i Zvezdas: Shaqiri do të jetë nën presion të madh se e di ku po vjen, por ne duhet ta mbrojmë në rast të situatave të padëshirueshme “Unë mendoj se Shaqiri do t’i nënshtrohet presionit të jashtëzakonshëm psikologjik. Ai e di se ku do të shkojë. E di mirë se klubi ynë është një simbol i Serbisë”, ka thënë fillimisht tha Terzic për gazetën serbe Kurir. “Nuk e di nëse ai do të jetë i gatshëm të luajë në Serbi, në këto kushte, kështu që dyshoj se do të vijë. Ne duhet të bëjmë gjithçka që mundemi që Shaqiri të ndihet i sigurt për të luajtur futboll, është detyra jonë ta mbrojmë atë”, përfundoi ai.

Kush është Xherdan Shaqiri?

Xherdan Shaqiri (lindur më 10 Tetor 1991 në Zhegër, Gjilan), është futbollist zviceran me orgjinë shqiptare i cili luan me klubin anglez Liverpool në Premier League dhe me kombëtaren zvicerane si mesfushor. Që kur kaloi në skuadrën e parë të Baselit, Shaqiri është lavdëruar shumë për shpejtësinë e tij dhe për kontrollin e topit. Ëebfaqja zyrtare e FIFA-s e përfshkruan Shaqirin si të “paparashikueshëm me topin”, “i aftë me të dy këmbët” dhe me një “vizion të shkëlqyer. Ai e ka pseudonimin “Messi alpin” dhe “xhuxhi magjik”. Shaqiri ka lindur në Gjilan të Kosoves nga prindër kosoravo-shqiptarë. Ai emigroi në Zvicër në vitin 1992 me prindërit e tij dhe me tre vëllezërit dhe motrat e tij. Ai mori pasaportën zvicerane pasi është një zviceran i natyralizuar. Shaqiri ka luajtur për të rinjtë e SV Augstit dhe FC Baselit. Gjatë kohës që luante me të rinjtë e FC Baselit, ai konkuroi në Kupën Nike U–15 në vitin 2007 ku u emërua lojtari më i mirë i turnamentit. Pavarësisht se kishte disa klube që donin të firmosnin me të, ai vendosi të qëndrojë te Baseli, ku luajti me skuadrën e rezervave nga viti 2007 e deri në vitin 2009 në 1. Liga Zvicerane. Dy vite më vonë Shaqiri firmosi kontratën e parë si profesionist me Baselin më 2 Janar 2009, me kontratën e re që do ta mbante në St. Jakob-Park deri në vitin 2014. Më vonë ai ka qenë në skuadra të mëdha si Stoke City.

DAILY FRESH HALAL MEAT AND FRUIT

HILAL FOOD CENTRE
International Food Centre

318-324 Kilburn High Road,
London, NW6 2QN
020 7372 1059

VEAL SPECIAL OFFER